



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 4419 Prot

Shkodër, më 09.03.2020

URDHËR

Nr. 230, datë 09.03.2020

"PËR

MBYLLJEN E AKTIVITETEVE PUBLIKE DHE JOPIBLIKE, ANULLIMIN E GRUMBULLIMEVE MASIVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA, MBYLLJEN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË CONVID-19"

Në kuadër të masave të marra për përballimin e situatës së krijuar nga shfaqja e rasteve të para nga koronavirusi në Shqipëri, në mbështetje të urdhrave nga dikasteret qendrore, Bazuar në ligjin nr.139/2015 "Per vetqeverisjen vendore", i ndryshuar, pika 2 , Neni 8 "Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor", kreu III "Të drejtat dhe përgjegjësitë e njësive të vetqeverisjes vendore", në zbatim të ligjit 15/2016 "Për marandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", në zbatim të Urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, nr 1303 Prot., datë 09.03.2020 "Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së CONVID -19", Në zbatim të urdhërit nr. 132, datë 09.03.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale",

URDHËROJ

1. Pezullimin deri në një njoftim të dytë të aktivitetit mësimor dhe dhe çdo aktiviteti tjetër në shkolla, kopshte dhe çerdhe dhe qendra në territorin e Bashkisë së Shkodrës.
2. Pezullimin e çdo aktiviteti në institucione publike dhe jo publike në territorin e Bashkisë së Shkodrës, të tilla si: aktivitete sportive, aktivitete kulturore dhe konferenca, tubime dhe takime me pjesëmarrje masive, në vende të mbyllura apo të hapura, psh koncerte, tubime dhe dëgjesa publike.

3. Stafet e institucioneve publike në varësi të Bashkisë Shkodër dhe të ndërmarrjeve në varësi dhe në pronësi, do të vazhdojnë të paraqiten në detyrë. Detyra e tyre prioritare do të jetë monitorimi i situatës dhe mbikëqyrja e higjenës dhe pastërtisë së ambjenteve funksionale, në zbatim të orientimeve të OBSH-së.
4. Duke filluar nga data 10 mars 2020 e në vazhdim do të vijojë dizinfektimi i të gjitha institucioneve publike në varësi të Bashkisë Shkodër, institucione administrative, shkolla, kopshte e çerdhe, konvikte, qendra në territorin e Bashkisë Shkodër.
 - a) detajimi i kalendarit për disinfektim: (brenda dates 09.03.2020)
 - b) detajimi i fondit për kryerjen e shërbimit, (brenda dates 09.03.2020)
 - c) kryerja e procedurës së prokurimit të shërbimit të dizinfektimit. (brenda dates 10.03.2020)
 - e) monitorimin e kryerjes së shërbimit të dizinfektimit. (10.03.2020 - e në vijim)

Për këtë ngarkohen me përgjegjësi:

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve mbështetëse: për disinfektimin e ambjenteve të institucioneve administrative dhe të shërbimit social në funksion të administratës vendore.
- Drejtoria Çerdheve dhe Kopshteve: për disinfektimin e ambienteve të institucioneve të arsimit parashkollor dhe çerdheve.
- Drejtoria Ekonomike e Arsimit: për disinfektimin e ambienteve të institucioneve të arsimit shkollor baze dhe parauniversitar.
- Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a: për disinfektimin e ambienteve në shërbim të publikut, dhe që ka në administrim.
- Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore: për disinfektimin e ambienteve që ka në administrim.
- Drejtoria e MZSHSH, për disinfektimin e ambienteve që ka në administrim.
- Drejtoria ekonomike e Kultures: për disinfektimin e ambienteve në shërbim të publikut dhe që ka në administrim.
- Sport Klub "Vllaznia": për disinfektimin e ambienteve në shërbim të publikut dhe që ka në administrim.
- Teatri "Migjeni": për disinfektimin e ambienteve në shërbim të publikut dhe që ka në administrim.

5. Të raportojnë, për punën e kryer në vijim, çdo ditë pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të infrastruktures, pranë zv. Kryetarit të Bashkisë që mbulon emergjencën civile, dhe Kryetarit të Bashkisë.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

